



International
Labour
Organization



Empowered lives.
Resilient nations.

Projekti "Adresimi në nivel lokal i sfidës së punësimit të të rinjve në Shqipëri"

THIRRJE PËR APLIKIME PËR GRANTE

Grante për bujtinat në rajonin e Kukësit

1. Përshkrimi i projektit

Projekti i financuar nga SDC (Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) në lidhje me Adresimin në Nivel Lokal për Sfidën e Punësimit të të Rinjve e njihet rolin kyç që autoritetet rajonale\lokale mund të luajnë në trajtimin e sfidave të tregjeve lokale të punës, si edhe me masat e ndërmarra nga institucionet qëndrore. Bazuar në eksperiencën e mëparshme në kuadrin e Projektit të Përbashkët të OKB për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve (PMR), kjo ndërhyrje synon konsolidimin dhe zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve lokale në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të papunësisë. Paktet Territoriale të Punësimit (PTP) përfaqësojnë një risi institucionale e cila është e bazuar në konsultime dhe në planifikim të negociuar midis aktorëve publikë dhe privatë në nivel kombëtar dhe lokal, aktorë të cilët bashkohen për hartimin e objektivave të punësimit duke e vënë theksin tek formalizimi i punëtorve të rinj dhe krijimi i vendeve të punës.

Paktet projektohen si partneritete nga poshtë-lart me qëllim që të nxisin iniciativat dhe skemat që e trajtojnë papunësinë që në rrënjë. Në të njëjtën kohë masat e PTP-së mbështesin politikatat të cilat synojnë zhvillimin dhe formalizimin e sektorit bujqësor duke promovuar formalizimin e NMV-ve veçanërisht në zonat e thella.

Ngritja dhe funksionimi i Bordeve Rajonale të Punësimit, të cilët institucionalizojnë rrjetet e aktorëve lokalë, e rrit besimin në lidhje me mundësinë e përsëritshmërisë së këtij modeli përtej kohëzgjatjes së projektit. PTP-të, si instrumente politike efikase të cilët mund të katalizojnë lloje të reja bashkëpunimi dhe veprimi, janë replikuar edhe në rajonet e Kukësit dhe Shkodrës dhe tani po testohen për herë të parë në rajonin e Lezhës.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

Gama e rezultateve dhe e mësimave të nxjerra mund të vazhdojë në territoret e përfshira në Pakt edhe përtej periudhës së mbështetjes nga projekti (dmth mund të jetë i qëndrueshëm) dhe gjithashtu mund të jetë i rëndësishëm edhe për aktorë të tjerë të cilët po përpiqen të kryejnë ndërhyrje të të njëjtit lloj (shpërndarja) apo të formulojnë përgjigje për politikën (përfshirja), ose të dyja.

Një nga aktivitetet e veçanta, pjesë e Paktit Territorial të Punësimit në rajonin e Kukësit është nxitja e punësimit të të rinjve në sektorin e turizmit në zonën e Shishtavecit.

Objektivi specifik i kësaj mase është:

Mbështetja e punësimit të të rinjve nëpërmjet përmirësimit të standarteve të akomodimit dhe zhvillimit të aftësive që lidhen me turizmin.

2. Aktivitetet

Në vitin 2010, u hartua një Strategji gjithpërfshirëse për Turizmin në Rajonin e Kukësit si edhe një Plan Veprimi me qëllim orientimin e zhvillimit të turizmit në rajon gjatë 10 viteve të ardhshme.

Në të shkuarën janë kryer shumë ndërhyrje të cilat kanë ofruar ndihmë për 34 pronarë hotelesh/bujtinash, 7 restorante dhe 26 prodhues punimesh artizanale në lidhje me përmirësimin e planeve të tyre të biznesit si edhe për rritjen e aftësive të tyre reklamuese. Disa aktivitete të tjera kanë qenë të lidhura edhe me pjesëmarrjen në panaire të punimeve artizanale. Meqenëse kjo ndërhyrje është plotësuese për mbështetjen e ofruar deri tani, fokusi i saj mbetet tek mbështetja e zhvillimit të aftësive që lidhen me turizmin.

Përmirësimi i standartit të akomodimit në bujtinat e zonës së Shishtavecit, së bashku me zhvillimin e aftësive kanë mundësi të influencojnë punësimin e të rinjve në këto zona.

Me qëllim arritjen e rezultateve të dëshiruara do të organizohen aktivitetet e mëposhtme:

1. Identifikimi i bujtinave ekzistuese të cilat mund të ofrojnë mundësi punësimi në zonën e Shishtavecit. Grantet do t'u ofrohen pronarëve të bujtinave të cilët angazhohen për punësimin e të rinjve të zonës, në këmbim të investimit të bërë.
2. Ofrimi i trajnimit për 15 të rinj në fushën e kujdesit ndaj klientit, aftësive udhërrëfyese, komunikimit në gjuhën angleze dhe sipërmarrjes. Kjo mbështetje për zhvillimin e aftësive duhet të shihet si plotësuese për ndërhyrjen në bujtinë, ku projekti do të mundësojë lidhjen midis të rinjve të trajnuar dhe bujtinave.
3. Të rinjtë e trajnuar do të nxiten për krijimin e një ose më shumë ndërmarrjeve. Personat e interesuar (në grupe të përbëra nga më shumë se 2 persona) për krijimin e një ndërmarrje do të kenë të drejtën e përfitimit të një granti deri në 3,000 dollarë për grup, me kusht regjistrimin ligjor të subjektit. Në rast se hartohen më shumë se 3 plane biznesi, ndërhyrja do të mbështesë më të përshtatshmin për t'u zbatuar.
4. Përgatitja e fletëpalosjeve me informacion turistik dhe i udhëzuesve turistikë.

3. Modalitetet e skemës së grantit

Thirrja aktuale për aplikime do të shënjestrojë deri në 15 bujtina në zonën e Shishtavecit. Për të mbështetur këtë iniciativë ekziston një fond prej 15,000 dollarësh, që nënkupton shumën prej 3,000 dollarë për secilin grant.

4. Pjesëmarrësit e mundshëm

Pronarët e bujtinave në zonën e Shishtavecit të cilët janë të interesuar për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe punësimit. Në formularin që gjendet tek Shtojca, pjesëmarrësit duhet të përshkruajnë se cilat shërbime dëshirojnë të përmirësojnë nëpërmjet kontributit të projektit dhe cili është impakti që ato parashikojnë në lidhje me punësimin.

Afati përfundimtar: Aplikimet duhet të dërgohen me postë ose personalisht në 2 (dy) kopje (1 origjinale dhe një kopje) jo më vonë se fundi i ditës së Dielë, datë 5 Janar, 2014 në adresën e mëposhtme:

Z. Bukurosh Onuzi
Koordinator Rajonal për Kukësin
Adresa: Këshilli i Qarkut Kukës
E-mail: kukes_tep@ilo.org
Cel: +355 692096645

5. Përzgjedhja

Një panel përzgjedhës i kryesuar nga Këshilli i Qarkut Kukës dhe i përbërë nga një përfaqësues nga bashkia e Shishtavecit dhe nga projekti, do të kryejë vlerësimin e aplikimeve të dorëzuara dhe do të bëjë propozimin e granteve. Duke patur parasysh kufizimet në buxhet të kësaj Thirrje për Propozime do të bëhet financimi i vetëm pesë propozimeve me pikët më të larta. Anëtarëve të panelit do t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë paanësie.

Shënim: Lëvrimi i fondeve do të jetë subjekt i disponueshmërisë së tyre nga Donatori.